



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Njësia Org. 02/Kom/196 Nr. Prot. 294-3/2023
Org. Jedin. Org. Unit Prot. No.
Nr. i faqeve 2 Data 18.08.2023
Broj stranica No. pages: 2
Datë PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Bali Muharremi , Kryetar i Komunës së Suharekës
	Bexhet Kuçi , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Resul Makreshi , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	Bora Duli , Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Muharremi,
I nderuari Kryesues z. Kuçi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimin nr. 400-47547 për ndarjen e mjeteve financiare klubit të futbollit "Ballkani" në vlerën 40.000 Euro për ushtrimin e aktiviteteve sportive

I miratuar më datë 28.07.2023

I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 31.07.2023

I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 03.08.2023

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit përmbyajtësor të aktit të mësipërm të Komunës së Suharekës, jep konstatime bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

1. Komuna e Suharekës, me anë të aktit administrativ që është subjekt i shqyrtimit, synon për ndarjen e mjeteve financiare klubit të futbollit "Ballkani" në vlerën prej 40,000.00 € (dyzet mijë euro) për ushtrimin e aktiviteteve sportive.
2. Si pikë e parë, edhe përkundër faktit se Komunave iu jepet pavarësi financiare në menaxhimin e financave të tyre, ashtu të precizuara me nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Komunitat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP"), gjatë disponimit me të hyrat financiare komunale, e përcaktuar si në vijim:

Neni 7

Burimet Financiare Komunale

7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.

3. Më tutje, një tregues i rëndësishëm për të konstatuar ligjshmërinë e aktit komunal është ndarja buxhetore e kategorizuar në bazë të programit dhe/apo klasifikimit ekonomik. Kështu që, me nenin 1 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116,

me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21, ndarja buxhetore përkufizohet si:

“...shuma maksimale e përcaktuar në një Ligj për Ndarjet Buxhetore e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga një organizatë buxhetore gjatë vitit fiskal për shpenzim **në një program të caktuar ose kategori tjetër shpenzimi.**”


4. Në këtë kuptim, çdo shpenzim i një organizatë buxhetore duhet të ketë të evidentuar **kategorinë dhe/apo programin e caktuar të shpenzimit.** Si plotësim i kësaj, çdo kategori dhe/apo program i organizatave buxhetore e ka shumën maksimale në dispozicion për shpenzim, e që në esencë duhet të ketë për bazë ndarjet e përcaktuara sipas Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.
5. Në rastin konkret, Komuna e Suharekës në vendimin i cili është subjekt i ligjshmërisë, ka dështuar ta specifikojë nën-programin e caktuar të shpenzimit, kategorinë e shpenzimeve dhe burimet e fondeve, dhe rrjedhimisht nga ku po financohet masa e përcaktuar me vendimin administrativ komunal. Në mungesë të këtij specifikimi dhe/ose precizimi, Ministria e ka të pamundur të bëjë konstatimin nëse komuna ka mjete të lira për zbatimin e aktit komunal.
6. Gjithashtu, akti komunal i plotëson kriteret për t'iu nënshtuar rregullave të ndihmës shtetërore, të përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore (këtej e tutje referuar si "LNSH"), marrë për bazë se ky i fundit potencon që ndihmë shtetërore konsiderohet edhe çdo reduktim i të ardhurave të shtetit.
7. Marrë për bazë konstatimin e mësipërm mbetet obligative për Komunën të respektojë dispozitën vijuese:
 - 7.1. **Nenin 7: Ndihma "De Minimis" të LNSH,** nëse kemi të bëjmë me përfitime në vlerë deri në 200,000 EUR (për 3 vite fiskale, për secilin subjekt afarist), dhe kështu sipas Nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2020 Për Ndihmën "De Minimis", institucioni dhënës obligohet që brenda 15 ditësh pas dhënies së ndihmës të raportojë nëpërmjet formularit të njoftimit konform Shtojcës 1 dhe 2 të Rregullores, në Departamentin e Ndihmës Shtetërore.
8. Si përfundim, **Ministria sqaron se akti i Komunës së Suharekës nuk është i zbatueshëm dhe i rekomandon Komunës të plotësojë/ndryshojë atë me nën-programin e caktuar të shpenzimit, kategorinë e shpenzimeve dhe burimet e fondeve.**

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Suharekës ndërmarrjen e veprimeve konkrete, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit, në mënyrë që masa e përcaktuar me aktin e komunës të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Suharekës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkatësi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MFPT		
Kopje:	Kryetar i Komunës së Suharekës Kryesuesi i KK-Suharekës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL		
Përmes:	Jeton Qela, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL		
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 01.08.2023 020-621	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave		
2.Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Driton Xhafa , Zyrtar për Monitorim të Komunave		
Lënda:	Shkresë përcjellëse në MFPT		
Eloji i aktit:	Vendim		

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin nr. 400-47547 për ndarjen e mjeteve financiare klubit të futbollit "Ballkani" në vlerën 40.000 Euro për ushtrimin e aktiviteteve sportive, nënshkruar nga Kryesuesi i kuvendit të komunës së Suharekës me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin nr. 400-47547 për ndarjen e mjeteve financiare klubit të futbollit "Ballkani" në vlerën 40.000 Euro për ushtrimin e aktiviteteve sportive.

I miratuar më datë: 28.07.2023


I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.07.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, lidhur me nenin 40, paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 2, të Ligjit Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr.27/2008", e konform nenit 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 28.07.2023, miratoi këtë:



V E N D I M

Neni 1

- 1.1 Me këtë vendim klubit të futbollit "Ballkani" me seli në Rr. "Stadiumi i qytetit" në Suharekë, i udhëhohet me mjete financiare në vlerë prej 40,000.00€ për ushtrimin e aktiviteteve sportive.
- 1.2 Mjetet lëshohen nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për kulturë, rinë, sport dhe mërgatë e Komunës së Suharekës, mjetet lëshohen në xhirologarin e klubit "Ballkani".

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për kulturë, rinë, sport dhe mërgatë dhe Drejtorinë për ekonomi, financa dhe buxhet në Komunën e Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-100-40511
Me datë 28.07.2023



Kryesuesi i Kuvendit
Mr. Ed Bexhet KUÇI



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

Agjensioni i Regjistrimit të Biznesit në Kosovë / Kosovska Agencija za Registraciju Biznisa /
Kosova Business Registration Agency

CERTIFIKAT E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810079196

(Nr. i biznesit / Br. biznisa / Business No.)

Klubi i Futbollit " Ballkani " SH.P.K.

Emri i biznesit / Naziv biznisa / Name of Business

Lloji i biznesit
Business Type
Tip biznisa

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Limited liability company
Društvo sa ograničenom odgovornošću

Adresa
Address
Adresa

Republika e Kosovës, Shtetërore, Shtetërore
Republic of Kosovo, Suva Reka, Suva Reka
Republika Kosova, Suva Reka, Suva Reka
Rr. Stadiumi i Qytetit në Shtetërore


Data e inkorporimit
Date of Incorporation
Datum inkorporiraja

15/12/2017

Data e regjistrimit
Date of registration
Datum registracije

19/12/2017

19/12/2017
Data/Date/Datum



Nenshtkrimi/Signature/Polpis



REPUBLIKA E ALBANI
FEDERATA E FUTBOLLIT
SHQIPTAR

ARBK

ASOCIATA E REGJISTRIMIT
E KLUBEVEVE TE FUTBOLLIT

Klubi i Futbollit Ballkani SH.P.K.

Emri i biznesit	Klubi i Futbollit Ballkani SH.P.K.
Emri tregtar	FC Ballkani
Lloji biznesit	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Numri unik identifikues	810079196
Numri i biznesit	///
Numri fiskal	///
Numri certifikues KTA	///
Numri punëtorëve	50
Data e regjistrimit	18/12/2017
Komuna	Suharekë
Adresa	Suharekë, Rr. Stadiumi i Qytetit ne Suharekë
Telefoni	049 656 666
E-mail	///
Kapitali	150,000.00€
Statusi në ARBK	Regjistruar
Statusi në ATK	///

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Arsim	Kabashi	Drejtor menaxhues	Sipas ligjit dhe statutit. Perfaqesues i autorizuar

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Arsim Kabashi	150,000.00€	100.00%

Njësitë

Nr	Numri i njësisë	Emri	Vendi
----	-----------------	------	-------

Aktivitet/et

Kodi	Përshkrimi	Tipi
9312	Aktivitetet e klubeve sportive	Primare

Kodi	Përshkrimi	Tipi
9319	Aktivitetet e tjera sportive	Sekondarë
9509	Aktivitetet e tjera p.k.t.	Tjera
9313	Palestra e fitnesit	Tjera
7311	Agjencitë për publicitet.	Tjera
7312	Publiciteti përmes mediave	Tjera
8551	Arsimi për sporte dhe rekreacion	Tjera
9311	Funksionimi i objekteve sportive	Tjera